



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA

Emri i Autoritetit Kontraktues: **Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi**
dhe

Emri i Kontraktuesit: **N.T.SH. "Haxhi Benz" me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Igballe Sada**

janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS: **SERVISIMI I APARATEVE PËR SHUARJEN E ZJARREVE**

Numri i Prokurimit: 623-18-907-2-3-6

Numri i Brendshëm: 623-18-005-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Servisimi i aparateve për shuarjen e zjarreve**. Sipas Ofertës.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **22.03.2018** dhe përfundon me: **21.03.2019**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerje së shërbimeve do të jetë: **Servisimi i aparateve për shuarjen e zjarreve në Komunën e Rahovecit**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,890.00 €**

[Tremijë e tetëqindëntëdhjetë Euro e zero zero Cent] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas brezës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimi të tërë dërgesës]

[nëse kontrata përbëhet nga më shumë se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimi të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për....muaj, pas pranimi të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet, brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për

secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënues nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Igballe Sada	Emri:	Jetulla Kabashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.03.2018	Data:	22.03.2018
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



Drejtoria Për Mbrojtje dhe Shpëtim
Odeljenje za Zastitu i Spasavanje
Department for Protection and Rescue


Servisimi i Aparateve për Shuarjen e Zjarreve

Nr	Lloji i paisjeve	Njësia Matëse	Sasia	Servisim Dy herë	Çmimi	Gjithsej Vlera
1	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-9	Copë	322	2	2.70	1,738.80
2	Fletgarancioni	Copë	322	2	0.20	128.80
3	Blomba	Copë	322	2	0.20	128.80
4	Gas Azot për Aparate për shuarjen e zjarreve P-9	Copë	322	2	0.40	257.60
5	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-6	Copë	129	2	1.90	490.20
6	Fletgarancioni	Copë	129	2	0.20	51.60
7	Blomba	Copë	129	2	0.20	51.60
8	Gas Azot për Aparate për shuarjen e zjarreve P-6	Copë	129	2	0.20	51.60
9	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-30	Copë	7	2	6.70	93.80
10	Fletgarancioni	Copë	7	2	0.20	2.80
11	Blomba	Copë	7	2	0.20	2.80
12	Gas Azot për Aparate për shuarjen e zjarreve P-30	Copë	7	2	2.10	29.40
13	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-50	Copë	2	2	9.60	38.40
14	Fletgarancioni	Copë	2	2	0.20	0.80
15	Gas Azot për Aparate për shuarjen e zjarreve P-50	Copë	2	2	2.10	8.40
16	Servisimi i Aparatit për shuarjen e Zjarrit CO ₂ - 5 kg	Copë	72	2	3.00	432.00
17	Fletgarancioni	Copë	72	2	0.20	28.80
18	Blomba	Copë	72	2	0.20	28.80
19	Mbushja me pluhur të Aparatit për shuarjen e zjarrit, P-6	Copë	25	2	4.20	210.00
20	Fletgarancioni	Copë	25	2	0.20	10.00
21	Gas Azot për Aparate për shuarjen e zjarreve P-6	Copë	25	2	2.10	105.00
Totali						3,890.00

Vërejtje: Paramasa për Servisimin e Aparateve përfshin Dy (2) servise në afat kohorë Një (1) vjeçar. D.m.th: Mbushja e parë e aparateve kundër zjarrit kryhet pas nënshkrimit e kontratës, kurse mbushja e dytë bëhet pas skadimit afatit të parë.

Aparate për shuarjen e zjarreve të cilat janë të përkrahura në Paramas të gjitha gjinden në objektet e Komunës së Rahovecit: Objektet e Komunës, Zyre të vendit, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (Q.K.M.F) dhe Qendra e Mjekësisë Familjare (Q.M.F), Shkollat dhe Objekte tjera të caktuara.

O.E. fitues duhet ti mer nga vendi ku gjinden, ta bëj servisimin e aparateve dhe ti kthej në vendin e mëparshëm.



Handwritten signature